



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 132, dt. 15.06.2016

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.06.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi /rikonstruksioni i disa godinave ekzistuese si dhe disa pikave të reja (zyra informacioni) të ndodhura në zonat e mbrojtura, me subject aplikimi Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, si më poshtë:
 - Qendra e vizitorëve Llogora;
 - Kulla e vrojtimit të Zogjve Velipojë;
 - Qendra e vizitorëve Dajt;
 - Qendra e vizitorëve Theth
 - Qendra e vizitorëve Divjakë;
 - Qendra e Vizitoreve Rradhimë;
 - Qendra e vizitorëve Velipojë;
 - Qendra e vizitorëve Fushë Stude Librazhd;
 - Info Center Syri i Kaltër;
 - Rikonstruksioni i godinës së rojeve të postbllokut Dajt.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI